



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 1142 Prot.

Ballsh më, 28.02.2022

VENDIM

Nr. 16 Datë 28/02 / 2022

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË BASHKËFINANCIMIT NDËRMJET BASHKISË
MALLAKASTËR DHE MINISTRISË SË FINANCVE DHE EKONOMISË PËR
PROGRAMIN E STREHIMIT PËR VITIN 2022 ME OBJEKT: PËRMIRËSIM TË
KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETET E PAFORIZUARA**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM-së nr. 458, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, VKM-së nr. 823, datë 18.12.2019 “Për procedurën e blerjes së banesave në tregun e lirë që i shtohen fondit publik të banesave sociale me qira”, VKM-së nr. 301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kostot të ulët”, VKM-së nr. 579, datë 22.07.2020 “Për përcaktimin e institucioneve publike që administrojnë strehët, të kriterëve, procedurave dhe kapaciteteve të mjaftueshme për të menaxhuar ceshtjet sociale, financiare dhe teknike, si dhe të procedurave të administrimit e të mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme, kompetencave të subjekteve përgjegjëse dhe bashkëpunimit ndërmjet tyre”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 33, datë 26.08.2020 “Për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, si dhe shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 407 Prot., datë 12.01.2022 “Mbi fondet për projektet e strehimit për vitin 2022,

VENDOSI

- I. Miratimin në parim të bashkëfinancimit ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për implementimin dhe zbatimin e programit të strehimit për vitin 2022 “Përmirësim të kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara”.
- II. Bashkia Mallakastër do të marri përsipër pjesën e vetë takuese në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e parashikuar në buxhetin e vitit 2022 nga të të ardhurat e veta

KRYETAR

Mbarime Isufaj